

HERALDIKA NË TREVAT ARBËRORE

Dr. Sc. Pajazit **HJAZERI**

Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Ky punim synon të ofrojë të dhëna historike, një pasqyrë me karakter përmbledhës nga aspekti historik, politik - shoqëror, kulturor e shpirtëror. Interesimi për heraldikën ka qenë i pranishëm që nga antika dhe ka vazhduar deri në ditët e sotme. Me këtë rast mund të themi se heraldika lulëzimin e saj në trojet iliro - arbërore e ka përjetuar gjatë antikës dhe Mesjetës. Gjatë Mesjetës, heraldika lulëzoi pasi që emblema u bë pjesë e rëndësishme e jetës shoqërore, ekonomike, politike, kulturore dhe emblematike. Kështu, emblemat (Stemat) e tyre i posedonin qytetet, familjet fisnike, personalitetet e rëndësishme politike, korporatat, esnafët, repartet ushtarake etj. Me këtë rast po i theksojmë se edhe në Statutet e qyteteve simbolet gjenin hapësirë të mjaftueshme në kuptimin e zbatueshmërisë së saj.

Fjalë kyçe: heraldikë, simbol, stemë, statut, antikë, mesjetë.

ABSTRACT

This greatest work of history, a reflection of its historical, political - social, cultural and spiritual character. Interests have been present since antiquity and there are times to the present day. On this occasion we can say that heraldry flourished in the Illyrian-Arberian lands during antiquity and the Middle Ages. During the Middle Ages heraldry flourished as the emblem became an important part of social, economic, political, cultural and emblematic life. Thus, their emblems (Emblems) were possessed by cities, families, important political personalities, corporations, guilds, military units, etc. On this occasion I am emphasizing in the Statutes of cities that the symbols found more than even in the sense of its implementation.

Key words: heraldry, symbol, coat of arms, statute, antiquity, medieval.

HYRJE

Aplikimi i stemave, si karakteristikë e bujarisë e ka zanafillën që në antikitet. Atëbotë, në fushëbeteja, mbaheshin flamuj që kishin simbole, si; shqiponjat, ujqit, minotaurët, kuçedrat e bisha të tjera. P. sh., një nga legjionet e Cezarit mbante në flamur elefantin, ndërsa intenca e Augustit kishte për simbol vizual dorën dhe sferën si shenjë që do të tregonte se tërë bota i nënshtrohet pushtetit romak.¹ Heraldika (prej fjalës gjermanike *herold – kasnec*²) – emër që në fillim tregonte mbajtësin e një arme ose embleme, e më vonë emrin e personit që njihte gjithë patronët “shenjtorët” dhe familjet që iu përkushtoheshin.³ Është shkencë e cila e ndihmon shumë shkencën e historisë, e cila merret me studimin e krijimit dhe të zhvillimit të stemave, prandaj, sipas rregullave të konfirmuara, përcakton mënyrën e të paraqitjes të stemës në formë figurash dhe të përshkrimit. Kjo shkencë ka lidhje të ngushtë me sfragjistikën, me gjenealogjinë dhe me numizmatikën në përgjithësi.⁴ Burimet heraldike janë paraqitje në formë figurash të stemave në

¹ Shyqri Nimani, Trojet shqiptare në harta dhe stema ndër shekuj, Nga Straboni e Ptolemeu deri më sot, Prishtinë, 1996, p. 87.

² Kasnec – Lajmëtarë, ai që i bënë reklamë një pune a veprimi të dikujt; tellall, nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980, p. 795.

³ Jaho Brahaj, Emblema Shqiptare (Gjurmime Heraldike), Lezhë, mungon viti i botimit, p. 8.

⁴ Stjepan Antoljak, Shkencat ndihmëse të historisë, Prishtinë – Shkupë, 1972, p. 181.

stemëmbajtëse, në vula, në përmendore, në materiale prej guri, metali, druri, lëkure dhe materiali tjetër. Si burime më të vjetra janë dorëshkrimet e punuesve të stemave (frëngjisht: *armoriaux*, gjermanisht: *wappenbücher*, ndërsa anglisht: *roll of arms*) të shek. XII gjer në fund të shek. XV. Në këto gjenden stemat e sundimtarëve, magnatëve dhe fisnikëve të Evropës Perëndimore dhe të asaj Qendrore. Publikimi i parë nga lëmi i heraldikës, konsiderohet sundimtari gjerman *Fridrih I Barbarosa*, i cili e shkroi rreth vitit 1240 veprën me titull “*Clipearus clipeus Theutonicorum*”, ndërsa francezi *Clement Prinsault* (1416), konfirmoi i pari rregullat e heraldikës, kurse përfundimisht i mbarështoi *Claude Fañçosi Menestrier* (1677).⁵

HERALDIKA SI SHKENCË

Heraldika ka tetë rregulla themelore. *Rregulla e parë*: një stemë (emblemë) nuk guxon t’i përngjajë tjetrës, duhet të dallohet, së paku, në detaj. *Rregulla e dytë*: një familje, një qytet apo një shtet, nuk guxon të ketë në përdorim më shumë se një stemë në të njëjtën kohë. *Rregulla e tretë*: në heraldikë është e mirë vetëm ajo stemë që ka rregullsi heraldike, pa marrë parasysh se në ç’mënyrë artistike janë formësuar figurat e saj. *Rregulla e katërt*: çdo stemë e ka anën e djathtë dhe të majtë heraldike, duke u nisur nga ana e atij që e mban e jo nga ana e atij që e shikon mburojën. *Rregulla e pestë*: ngjyra e verdhë paraqet arin, ndërsa e bardha argjendin. Të dyja trajtohen si ngjyra metalike dhe nuk shkojnë njëra me tjetrën. *Rregulla e gjashtë*: mburoja e vendosur pjerrtas në stemë do të thotë se ajo stemë ka prejardhje të lashtë. *Rregulla e shtatë*: shtyllat e vendosura pjerrtas, tërthoraket dhe kordelet nga ana e majtë në anën e djathtë heraldike të mburojës, janë stema të familjeve ilegjitimë. *Rregulla e tetë*: te bashkimi i stemave të dy shteteve apo familjeve – stema e ngadhënjyesit është në mes të mburojës, ndërsa ajo e të pushtuarit apo ajo e të përngjiturit rreth saj.⁶

Heraldika si disiplinë e ka fillimin e praktikimit në Evropë në shek. XI, kohë kur filluan të kristalizohen rregulla në paraqitjen e simboleve në armët ushtarake, vulat dhe flamujt e feudalëve, shteteve e koalicioneve ushtarake. Këto rregulla fillesën e kanë në karakterin praktik, që të lehtësonin identifikimin e forcave ushtarake në fushat e betejës, ku simbolet që mbanin në mburoja dhe në flamujt e tyre, e bënte të lehtë njohjen e reparteve ndërmjet tyre dhe kundërshtarit dhe lidhjet me komandantët e tyre. Këto simbole që në fillim u praktikuan për qëllime identifikimi më vonë u zhvilluan edhe në drejtimin artistik të tyre dhe në momentin që ata filluan të krijonin rregullsi njohje e individualiteti të feudalëve, shteteve etj. Kjo tërësi rregullash u kristalizua në disiplinë, e cila duhej njohur nga bashkëkohësit për nevojat e organizimit politik, ushtarak e shoqëror.⁷

Kjo disiplinë u emërua “heraldikë” nga emri i atij personi që kishte detyrë të njihte këtë rregullsi tek fqinjët, eprorët e feudalit që i shërbente, të vasalëve të tij dhe të mbretit nga i cili varej. Heraldikë kishte detyrë të drejtonte ceremonitë e oborreve, të mbante të vizatuara emblemat, vulat dhe flamujt e të gjithë atyre që kishin të bënin me zotin e tij. Emblemat heraldike ishin tashmë të përcaktuara qartë në ndryshim nga periudha paraardhëse ku kushdo, pa një rregullsi mbante simbole të ndryshme si në kohë dhe territor, por edhe brenda të njëjtit formacion politik e shoqëror. Emblemat ndryshonin, por tashmë me rregullsi dhe të shpallura publikisht. Ndryshimet bëheshin për arsye të zgjerimit ose zvogëlimit të territorit, të vasalitetit

⁵ Ibid. p. 181.

⁶ Sh. Nimani, Trojet shqiptare, op. cit. p. 88.

⁷ Jaho Brahaj, <http://www.radiandradi.com/heraldika-shqiptare-nga-jaho-brahaj/>

në të cilin i perplaste jeta, nga lidhjet me krushqi, nga aleancat dhe nga ndarja e një dere në dy apo më shumë degë.⁸

Sikurse pamë, emblemat heraldike filluan të përdoren nga shek. XI e këtej. Edhe më parë familje e territore të veçanta kishin në disa raste simbolet e tyre, por këto simbole u kthyen në emblema heraldike me zhvillimin e koncepteve heraldike që kërkonin si rregull që çdo derë e familje fisnike të kishte simbole – emblemat e veçanta. Zakonisht, për shekujt e parë, kur u zhvillua heraldika, flamuri, emblema e shtetit dhe vula kishin të njëjtat simbole, por kjo nuk është rregull, sepse ka edhe raste me përjashtime. Çdo emblemë ka edhe ngjyrat e saj edhe çdo ndryshim ngjyre përfaqëson një emblem tjetër, po kështu çdo ndryshim i simboleve, qoftë duke hequr ose duke shtuar, përfaqëson një emblemë tjetër.⁹ Vepra e parë e shtypur mbi heraldikën u botua në Londër në vitin 1480, vepër kjo që e shënoi N. Upton me titull “*De studio militari*”, kurse më 1529 në Venedik doli pastaj “*Catalogus gloriae mundi*” nga Burgundasi B. Casaneusi.



Pikërisht gjatë shek. XVI, interesi për heraldikën në Evropë shtohet gjithnjë dhe fryt i këtij interesimi janë një numër i madh punimesh nga kjo lëmi.¹⁰ Fusha studimore që meret heraldika është studimi i emblemave, stemave, vizatimeve, që mbajnë ndër veshjet e tyre një familje, një qytet, një organizatë e caktuar, ushtria etj. Meqenëse vizatimet e emblemave janë shpesh pjesë e një vule, heraldika si shkencë është e lidhur ngushtë me sfragjistikën, antroponiminë, burimet historike, gjenealogjinë, shkallën e zhvillimit të artit grafik, këto të lidhura me simbologjinë dhe sociologjinë. Këto disiplina kanë ndihmuar heraldikën dhe ndihmojnë studimin e saj, por dhe heraldika. Meqë emblemat janë të lidhura me trashëgiminë, heraldika është e lidhur gjithashtu ngushtë me gjenealogjinë. Emblema është një shenjë e qëndrueshme për një person, familje apo institucion, e cila është bërë në përputhshmëri me disa rregulla. Një emblemë e veçantë mund të jetë shenjë për një familje të veçantë, një feud, një pronë territoriale, ose shenjë e një territori të tërë të një vendi.¹¹

Emblemat janë përdorur më së pari gjatë kohës së kryqëzatave dhe fillimisht shërbyen si një instrument për të njohur njerëzit që i përkisnin një fisniku të veçantë. Shenja e tij udhëhiqte njerëzit që ai kishte me vete. Shenjat e veçanta të përdorura prej togave në ushtritë moderne, të cilat qenë krijuar vetëm në shekullin XX, janë një paralele moderne e tyre.¹²

8 Ibid.

9 Jaho Brahaj, Emblema Shqiptare (Gjurmime Heraldike), Lezhë, mungon viti i botimit, p. 5.

10 S. Antoljak, op. cit. p. 181.

11 Jusuf Osmani, Arkivistika, Teoria dhe praktika, Prishtinë, 2005, p. 25.

12 Walter Höflechner, Gëzim Hoxha, Romeo Gurakuqi, Hyrje në studimin e Historisë, Shkodër, 2004, p. 107.

Heraldika si fushë studimore, ka zhvilluar një terminologji të veçantë të saj. Studiuesit e kësaj dege në radhë të parë sigurojnë që çdonjëri zbaton numrin e madh të rregullave të heraldikës. Pjesa kryesore e një embleme është mburoja. Një pjesë e dytë kryesore është helmata dhe dekoracionet mbi helmata, pjesët e veshjeve të varura poshtë pjesës së prapme të helmata. Në vend të helmata, për të treguar rangun e personit, janë përdorur gjithashtu kurorat. Sa më shumë maja kishte kurora, aq më i lartë ishte rangi.¹³



Fig. - 1 Stemat e Papëve nga viti 1198 deri në vitin 2005

Emblema përher është përshkruar nga pikëpamja e personit i cili e ka mbajtur mburojën. Ajo çfarë duhet të jetën krahun e djathtë nga pikëpamja e shikuesit, merret si e krahut të majtë në heraldikë. Piktura e një embleme koinsiston me ngjyrat dhe me figurat. Ekzistojnë rregullat strikte për kombinimet e mundshme të ngjyrave dhe përdorimeve të tyre. Ngjyra e argjendtë – e bardha, ngjyra e artë, e verdha, mund të përdoret vetëm prej Papës. Në përgjithësi, për të tjerët “ngjyrat metalike”¹⁴ mund të përdoren të kombinuara me ngjyra të tjera natyrore. Kjo për arsye se përdorimi i ngjyrave metalike të kombinuara, krahas ngjyrës tjetër metalike, ishte e ndaluar nga rregullat, pasi përdorej vetëm nga Papa.¹⁵

SHENJAT SIMBOLIKE ME KARAKTER TË SIMBOLEVE HERALDIKE

Njëra ndër tiparet e autonomisë qytetare bën pjesë prerja e monedhave, masa dhe pesha vetjake si dhe emblema dhe vula e qytetit. Një karakteristikë e veçantë e drahmeve “ilire”, është përdorimi i gjerë i shenjave simbolike mbi faqet e monedhave. Këto simbole figurative, ndonëse zbukurojnë faqet e drahmës, lidhen një pjesë dërmuese të tyre me emrin e shpinës kjo do të thotë se shenjat simbolike na paraqesin si të themi, stemën familjare ose personale.¹⁶



Fig. - 2, 3 Monedhë ilire dhe monedha mesjetare nga Shkodra¹⁷

¹⁴ Ngjyrat metalike konsiderohen ngjyra e argjendit dhe ngjyra e arit.

¹⁵ W. Höflechner, G. Hoxha, R. Gurakuqi, Hyrje në stud. e His. op cit. p. 107.

¹⁶ Hasan Ceka, Probleme të Numismatikës Ilire, Me një katalog të monetare të pa botuese apo të rralla të Ilirisë së Jugut, Tiranë, 1965, p. 57.

¹⁷https://www.google.com/search?q=monedha+nga+shkodra+mesjetare&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKewiJzYOenaL2AhWIR_EDHbcnBfoQ_AUoAXoECAEQAw&biw=1366&bih=625&dpr=1#imgrc=bwiUxdfn8gTfLM

Disa nga këto figura simbolike bëjnë patjetër aluzion mbi disa nga prodhimet më të pasura të hinterlandit ilir, që ishin burime kryesore të prosperitetit e të lulëzimit ekonomik të qyteteve. Si të tilla mund të konsiderohet kalliri i grurit, rushi dhe blea.¹⁸

Në drahmet ilire simboli kryesor shoqërohet me një ose dy figura të tjera. Me fjalë të tjera, shenjat simbolike mbi drahmet na japin edhe një pikëmbështetje për një klasifikim kronologjik më të përpiktë të simboleve në drahmet ilire. Një përpjekje e parë në këtë drejtim, ndonëse për pa i dhënë rëndësinë e duhur shenjave simbolike, ka pas qenë bërë edhe në të kaluarën.¹⁹ Edhe gjatë kohës së mesme (mesjetës) shumë komuna, si: Tivari, Ulqini, Drishti, Shkodra etj., emetuan edhe monedhat e tyre. Ato shërbenin kryesisht për të lehtësuar shkëmbimin e mallrave midis qyteteve dhe fshatrave që përfshiheshin brenda kufijve të komunës. Monedhat ishin prej bronzit. Ato mbanin në një rën anë stemën ose shenjtin mbrojtës të qytetit dhe në anën tjetër emrin e tij.²⁰

Përveç në monedha, simbolet heraldike gjenden në vulat kancelare, në shqytet luftarake, në afresket, nëpër rezidenca të ndryshme (të familjeve fisnike), nëpër monumente funerale, nëpër kisha e katedrale të ndryshme, manastire, në miniaturë etj. Origjina e simboleve është e gjerë dhe e larmishme. Ato janë figura njerëzish ose gjymtyrësh njerëzore, figura shenjtorësh, engjëjsh, shpendësh, kafshësh, figura të botës ujore, qiellore, bimore, krijesa fantastike, simbole të fortifikimeve të ndryshme, mjete detare, si dhe mjete armatimesh.²¹ Që disa motive gjeometrike kanë pasur domethënie simbolike ose magjike së pari e dëshmuar etnologët, të cilët e vërtetuan këtë duke studiuar kulturat primitive të Afrikës, të Azisë, të Amerikës së Jugut etj. Ata dëshmuar gjithashtu se fiset ose popuj të ndryshëm të njëjta motive u atribuojnë ndonjëherë domethënie të ndryshme simbolike dhe kështu me vija zigzage disa e paraqesin gjarprin, të tjerët rrufenë, zjarrin, lumin; por edhe syrin e zotit (në krishtërizëm p.sh.), mirëpo, veç kësaj mund të ketë edhe fuqi apotropike²² (send që, sipas bestytive, mund të prapësojë një të keqe – hajmali). Studimi i kujdesshëm i ornamentikës së kësaj kohe ka treguar se edhe ajo ka pasur, në disa raste, përveç funksionit dekorativ, edhe atë simbolik. Duke u mbështetur në bibliografinë e pasur që është shkruar deri tani mbi simbolikën e motiveve ornamentale parahistorike, mund të përfundohet se motivet e shumta dhe të shumëllojshme që dëshmojnë në stolisjen ilire, në qeramikë, pllaka guri, monedha e objekte të tjera, kanë pasur po ashtu kuptime simbolike, sado që është vështirë të thuhet gjithmonë çfarë kuptimi iu kanë dhënë ilirët në kohra e në vise të ndryshme secilit motiv ornamental.²³

MONUMENTET HERALDIKE NË TROJET SHQIPTARE

Monumentet heraldike që ruhen në truallin autokton shqiptar, janë të pakta për arsye që dihen. Pushtimi pesë shekullor osman la pasojë të mëdha në këtë drejtim sepse zhdukuri qytete e dogji krahina. Pushtues e armiq të popullit tonë kanë punuar sistematikisht për zhdukjen e këtyre monumenteve që dëshmonin fazën e lartë të qytetërimit të kombit tonë në Mesjetën e vonë. Nga pushtimi i serbëve, në vitin 1912, u zhdukën tri emblema në kalanë e qytetit të Lezhës. Po nga trazirat e këtij fillim shekulli u zhdukën disa emblema

18 Ibid. p. 57.

19 Ibid. p. 59.

20 Aleks Buda, Shkrime historike 3, Tiranë, 2002, p. 148.

21 Gjin Varfi, Heraldika Shqiptare, Tiranë, 2000, p. 13.

22 Aleksandër Stipçevisq, Ilirët Historia, Jeta, Kultura, Simbolet e kultit, Tiranë, 2002, p. 265.

23 Ibid. p. 265.

nga muret e kështjellës së Durrësit. Gjatë gjysmës së parë të shek. XX u zhduk emblema me shqiponjën dykrenore në Jabllanicë (Kosovë). Në vitin 1912, serbët grabitën gurët e disa varreve monumentale në periferi të Tetovës. Gjatë trazirave të vitit 1997, u zhduk emblema e Shtetit Shqiptar të Skënderbeut në portën e kështjellës së Himarës. Mund të rendisim edhe fakte të tjera të njohura. Për fat na janë ruajtur në truallin tonë emblema e Skurajve, Engjëllorëve, Topiajve, e Kastriotëve, Gropajve, Shtetit të Arbrit e disa emblema të tjera të gdhendura në gur ose të pikturuara e disa të tjera të paidentifikuara deri me tash nga studiuesit.²⁴

Heraldika në Shqipëri, si pjesë përbërëse e heraldikës evropiane, është e barasvlershme historikisht, artistikisht dhe njëkohshme me të. Në trevat shqiptare heraldika kaloi në faza të përcaktuara zhvillimi. Ajo i pati periudhat e saj të zhvillimit me ato ndërprerje që pati edhe tradita heraldike në mbarë Ballkanin. Gjurmët më të hershme të saj i gjejmë në shek. XIII me simbolin e sundimtarit të Shtetit të Arbrit, Dhimitrit të Arbrit, e ndjekur prej Gropajve, Skurrajve, Jonimëve, Topiajve, Dukagjinëve, Arianitajve, Muzakajve, Engjëjve, Despotëve Bua, Balshajve, Shpatajve e kurorëzohet me atë të Kastriotëve.²⁵ Në fazën e dytë, ajo u zhvillua në ato territore shqiptare, kryesisht bregdetare, që mbetën përkohësisht nën Venedikun e sidomos të Republikës së Shën Markut, duke pasur një hapësirë të kufizuar të zhvillimit. Në fazën e tretë, heraldika u zhvillua, kryesisht, në komunitetet arbëreshe brenda dhe jashtë trevave të Ballkanit, nëpër Mesdhe dhe në mbarë Evropën.²⁶

Zhvillimi ekonomik, kulturor e legjislativ i Arbërisë në shekujt e para pushtimit otoman kristalizoi forcimin e zhvillimin e shumë qyteteve shqiptare, të cilat disa kishin vazhdimësi që nga kohët e lashta si Shkodra, Lezha, Durrësi, Prizreni, Janina, Ulqini, Berati, Janjeva, Vlora, por krahas tyre linden e u zhvilluan në një hap me qytetet e vendeve evropiane edhe Danja, Zvaqi, Drishti, Shurrdhahu. Me këtë zhvillim që patën këto qytete, arritën të kenë statutet dhe emblemat e tyre. Nga këto ne sot njohim emblemat e qyteteve, Shkoder, Durrësit, Beratit, Tivarit, Ulqin, Lezhë, Artë, Zvaq (Shasi i sotëm), Drisht etj.²⁷




Fig. - 4 Stemat: 1. Durrësit, 2. Shkodrës, 3. Beratit, 4. Tivarit.

Simbolet e qyteteve ishin të ruajtura edhe me statutet e vet qytetit, p. sh. Statutet e Shkodrës në; Kreu 248, “Falsifikimi i shenjës së Komunës”, thuhet: “Nëse provohet se dikush ka falsifikuar vulën e Komunës,

²⁴ J. Braho, material nga internet.

²⁵ Gji. Varfi, Heraldika. op. cit. p. 15.

²⁶ Ibid. p. 15.

²⁷ J. Braho, op. cit.

masën, formën dhe ngjyrën e saj për ndonjë qëllim të mbrapshtë, të dënohet me 100 hyperperë, gjysma e të cilave i shkon gjykatës dhe Komunës, dhe gjysma tjetër denoncuesit. Falsifikuesi dhe tradhtari nuk duhet të ketë të bëjë më me Komunën”.²⁸ Ndër tiparet e autonomisë qytetare në emblemat e tij bën pjesë prerja e monedhave, masa e pesha vetjake si dhe vula e qytetit. Tivari, Ulqini dhe Shkodra kishin punishtet e veta për prerjen e monedhave, edhe gjatë kohës së sundimit të Balshajve. Si rregull paraqitej në to patroni i qytetit – Shën Mëria në Ulqin, Shën Stefani në Shkodër, Shën Trifoni në Kotorr²⁹ etj.

Një tjetër emblemë sovraniteti ishin masat dhe peshat vetjake për komunat, sidomos për prodhime bujqësore si vera, drithi dhe vaji i ullirit. Ato përfaqësonin edhe një burim të ardhurash për komunat. Në Shkodër masat kontrolloheshin çdo muaj.³⁰ Së fundi, vula e qytetit ruhej më shumë adhurim si emblemë e mëvetësisë së komunës. Falsifikimi i saj në Shkodër ndëshkohej rëndë. Ajo ruhej së bashku me dëshmitë e privilegjeve në një vend me tre dryna, për të cilët kishte nga një çelës secili prej tre gjykatësve.³¹ Përveç, qyteteve dhe familjeve të mëdha feudale, simbolet e veta i kishin edhe esnafet e ndryshme shqiptare, ashtu si edhe ato të vendeve të tjera, apo korporatat evropiane, të cilat kishin simbolin e tyre, bajrakun. Por jo çdo esnaf kishte flamurin e vet. Zakonisht këtë simbol nderi e kishin esnafet e mëdha me tradita të vjetra, si terezinjët, tabakët, gunëxhinjtë, kovaçët, takiexhinjtë, këpucarët etj. Esnafet e vogla, që nuk e kishin këtë, bashkoheshin nën flamurin e organizatave më të mëdha të afërta me zejet e tyre.³²




Fig. - 5 Stema e Arbrit

Stema e Shtetit të Arbrit

Pikëpamjet që kundërshtojnë origjinën ilire të shtetit të arbërve, përveçse janë në shërbim të politikës së manipulimit, ato i shërbejnë në esencë në mënyrë perfide mohimit të integritetit të shtetit iliro – arbëror.

28 Statuti di Skutari, della prima meta del sekole XIV con le addizioni fino al. 1469, a cura di Lucia Nadin, përkthyer në gjuhën shqipe nga Pëllumb Xhufi, Roma, 2002 p. 226.

29 Oliver Jens Schmitt, Arbëria Venedike 1392 – 1479, Përkthyer nga Adrian Klosi, Tiranë, 2007, p. 146 – 147.

30 Ibid. p. 147 .

31 Ibid. p. 147.

32 Zia Shkodra, Esnafet shqiptare (shek. XV – XX), Tiranë, 1973, p. 175.

Burimet që zotërojmë për historinë e ilirëve dhe arbërve dëshmojnë se historia e arbërve të mesjetës së hershme është vazhduese e historisë së ilirëve të antikitetit të vonë.³³

Ngjarjet politike që u zhvilluan në fund të shek. XII, si dobësim i pushtetit qendror bizantin, i dhanë mundësi bujarisë arbërore të krijonte shtetin e pavarur të Arbrit, i cili për kryeqytet kishte Krujën. Burimet e kohës dëshmojnë edhe për sundimtarët e shtetit të Arbrit, si, p. sh. Progoni (1190 – 1199), Gjini (1199 - 1208), Dhimitri (1208 – 1215), si dhe sundimtarë tjerë më pak të rëndësishëm, si Grigor Kamona, Gulami dhe Andrea Vrana.³⁴ Institucioni i sundimitarit të Arbrit ishte i trashëgueshëm, pra, është fjala për krijimin e një dinastie sunduesish, që ishte bërë tashmë një praktikë në tërë Evropën mesjetare.³⁵ Shteti i Arbrit kishte edhe simbolet e veta, ndër to edhe stemën e vet.

Stema e Skurrajve



Aty nga fillimi i shek. XIII, një pjesë e ultësirës midis Krujës, Tiranës e Durrësit, ku lokalizohet ekspansioni i Dhimitrit të Arbrit, quhej me emrin “Skurie”.³⁶

Fig. 6 Stema e Skurrajve

Takohemi me një emër gjerësisht të përhapur në toponimin e trevës së Arbrit, ku ende sot ai mbijeton si emër mali e fushe, emër fshati, lumi apo kështjelle. Gjatë shekujve të mesjetës emrin Skura e mbante njëra prej familjeve më të shquara feudale të Arbrit, lule e bujarisë shqiptare në shekujt XII – XIV.³⁷ Në një listë të vitit 1274, ku rreshtohen krerët e Arbrit, gjejmë në krye njërin pas tjetrit katër përfaqësues të familjes Skura; Mihal Skura, Leon Skura, Progon Skura, Tanush Skura.³⁸

Stema e Topiajve

Në fillim të shek. XIV në skenën politike shfaqet familja e madhe feudale Topiaj. Konti Tanush Topia quhet “zot i viseve midis Matit e Shkumbinit”, ndërsa pas tij, princi Karl Topia u bë “zot i gjithë viseve të Arbrit”. Ka shumë të ngjarë që midis Skurajve dhe Topiajve të ketë ndodhë një kalim stafete. Mundet që ky kalim pushteti nga Skurajt tek Topiajt të jetë shprehur në njëfarë mënyre edhe në stemën heraldike të Karl Topisë, siç e njohim nga ekzemplari i manastirit të Shën Gjon Vlladimitrit. Ajo riprodhon motivet e luanit që kishte qenë motivi qendror i stemës së Skurajve.³⁹ Fisniku Karl Topia është figura më e shquar e Topiajve, gjatë sundimit të të cilit principata e Topiajve arriti kulmin e lulëzimit të saj me qendër në Durrës, ku ndërtoi dhe një flotë luftarake detare. Me 1368, Republika e Venedikut e quan “*Karrollus Topie, princeps Albaniae*” (Karl Topia, princ i Shqipërisë). Papa Gregori XI i njeht titullin “*Konti i madh i*

33 Jahja Drançolli, *Arbrit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës*, Zagreb, 2008, p. 40.

34 *Ibid.* p. 49.

35 *Ibid.* p. 49.

36 Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbrit, Studime mbi Shqipërinë Mesjetare*, Tiranë, 2006, p. 79.

37 *Ibid.* p. 79.

38 *Ibid.* pp. 84 – 84.

39 *Ibid.* p. 86.

Arbërisë”. Më 1374 Karl Topia njihet në dokumentet e kohës dhe me titujt: “*Sundimtar i gjithë tokës së Arbëresheve*”, “*Dukë i Shqipërisë*”. Pranë stemës se tij ai shkruan: “*Këto janë shenjat e Zotit të Madh Karl Topia*”.⁴⁰

Stema e Dukagjinasve

Burimet historike, ndonëse japin të dhëna fragmentare, tregojnë se gjatë Mesjetës Dukagjinastit kanë qenë një familje fisnike e rëndësishme, prandaj emrin familjar të tyre e trashëguan ndër shekuj rajone të gjëra fushore e malore të Shqipërisë së Epërme, si dhe e drejta dokesore shqiptare e këtyre viseve.⁴¹



Fig. - 7 Stema e Lekë Dukagjinit

Emri familjar Dukagjini del për herë të parë në një dokument raguzan të vitit 1377 për një njeri me disa mbiemra “*Nikollë Stefan Tuderoviç Dukagjini*”. Ky mund të jetë paraardhësi i njëres degë fillestare të Dukagjinëve. Përfaqësues i njëres degë është Gjergji, që përmendet në vitin 1403 si pronari i dy fshatrave pranë Lezhës (Balldre dhe Kakarriq) dhe si komandant i një trupe prej 40 kalorësish e njëqind këmbësorësh.⁴² Familjen fisnike Dukagjini e ndeshim në shek. XV të ndare në dy dege. Pushteti i kësaj dege të re shtrihej kryesisht në verilindje të Shkodrës. Nder figurat më të shquara të kësaj dege të re ishte Pal Dukagjini dhe i biri Lek Dukagjini. Stemën e kësaj dege e ndeshim dhe në Raguze më 1595.

Stema e Despotëve Bua



Despotë të familjes fisnike Bua janë: Gjini Bua Shpata (? – 1400), Murriq Bua Shpata (? – 1418) dhe Pal Bua Shpata (?-1408). Gjini Bua Shpata është figura më e shquar e periudhës mesjetare në trevat e jugut të Shqipërisë. Jetoj në gjysmën e dytë të shek. XIV.

Fig. - 8 Stema e Mërkur Buas

Rreth viteve 1355 shpallet prej vendasve Despot në Etole dhe më gjerë me qendër në Angjelokastër. Gjini Bua Shpata themeloi despotatin e arkës dhe u bë Despoti i saj (1374-1400), duke udhëhequr Principatën më të fuqishme në Shqipërinë e Jugut.

Stema e Arianitëve

Arianitët janë familje e madhe feudale, që njihen qysh nga fillimi i shek. XI (1001) dhe që ka luajtur një rol politik të rëndësishëm, sidomos në shek. XV. Stema e Arianitëve është e kaltër me një shqiponjë të artë dykrenore, krahëhapur.



17, Material i shkëputur nga interneti.
Tëresh, Tiranë, 2002, p. 307.

Stema shoqërohet me këtë motivacion: “Komino (Kominian) i derës së zotit Retini (Arianiti) të Shqipërisë mbi Skuteri (Skuterra), zot në anët e atij vendi, i cili u pranua dhe u bë anëtar i Këshillit të madh, sepse kështu iu duk me vend Sinjorisë Sonë për ta nderuar dhe për ta pasur simpatizant tonin. Kjo u bë në vitin 1464”.⁴³

Fig. - 9 Stema e Arianitëve

Stema e Balshajve



Shteti i Balshajve ishte formacioni feudal më i madhi që u krijua gjatë periudhës së Mesjetës në Shqipëri (shek. XIV – XV), me qendër politike Shkodrën. Stemën e Balshajve e gjejmë edhe në monedhat në kohën e sundimit të Gjergjit I Balsha (1379). Në periudhën e sundimit të Gjergjit II Strazimir Balsha (1385 – 1403), stema heraldike e Balshajve paraqitet në stadin e saj më të lartë. Shqyti me një kokë qeni me një hallkë rreth qafe, nga ku varen dy rripa mbajtës. Mbi shqyt një përkrenare e kurorëzuar, e vendosur gjysmë profil me një kryq të madh që e ndan katërsh fytyrën e mbuluar të përkrenares dhe me një

kryqth patën në gushë të saj.⁴⁴

Fig. - 10, 11 Stema e Balshajve



Stema e Kastriotëve



“Skënderbeu, shkruante Marin Barleci, mbante flamur të kuq të qëndisur me shqiponja të zeza dykrenore. Ky ishte flamuri i fisit të tij”. Të njëjtën informatë e ofron edhe tradita popullore. Si simbol dhe shprehje e drejtpërdrejtë e identitetit kombëtar shqiptar flamuri i Skënderbeut ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve të huaj dhe shqiptarë.⁴⁵ Në shumë gravura e koleksione mbi stemat mesjetare të bëra nga autorë të ndryshëm gjatë shekujve XVI – XVII, të cilat e paraqesin elementin kryesor të stemës së kastriotëve, shqiponjën me dy krerë.

Fig. - 12 Stema e Kastriotëve

⁴³ Gj. Varfi, op. cit. p.48.

⁴⁴ Ibid. p. 40.

⁴⁵ Jahja Drançolli, Shteti mesjetar i Gjergj Kastriotit Skënderbeut, Pejë, 2001, p. 105.

Zbulimi më së fundi i gjurmës së vulës së madhe të Skënderbeut në dyllë në një dokument të dalë nga kancelaria e tij, që paraqet po ashtu shqiponjën dykrenore, vërteton përfundimisht jo vetëm saktësinë e burimeve relevante në lidhje me të, por edhe lejon të njihet saktësisht pamja e saj.⁴⁶ Por shumë i rëndësishëm në këtë aspekt është fakti se e njohim vulën e kryezotit të shtetit shqiptar të shekullit XV, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, e cila ruan edhe simbolin e flamurit tonë kombëtar.

Fig. – 13 Vula e Skënderbeut

Nga Kuvendi i Dukagjinit i viteve 1601 - 1602, ku morën pjesë përfaqësues nga 13 krahina shqiptare që nga Kosova, Dukagjini, Shpati e Muzeqeja, në përpjekje për çlirim nga pushtuesi, dokumentet përfundimtare e marrëveshjet mes tyre u vulosën me një vulë, forma grafike e së cilës është ruajtur, është përcjellë deri në ditët e sotme. Ajo ka mbishkrimin: “Sigillum Regni Macedoniae et Albaniae” (Vula e Mbretërisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë), e cila ka edhe ajo në mes shqiponjën dykrenare, pararendëse e shkabës në flamurin tonë kombëtar.⁴⁷ Bëhet fjalë për një vulë dylli origjinale, të përdorur nga Skënderbeu, e cila pritet të mbërrijë së shpejti për t’u ekspozuar në Muzeun Historik Kombëtar në Tiranë dhe në muzeun e Krujës. Sipas studiuesve dhe njohësve të epokës së Skënderbeut, kjo vulë mbart vlera të shumta historike si dëshmi materiale e kancelarisë së Skënderbeut. Përveç disa letrave nga korrespondenca e Skënderbeut, pak prej objekteve që ka përdorur ai kanë mundur t’i rezistojnë kohës e të ruhen deri sot.⁴⁸



⁴⁶ Ibid. p. 108.

⁴⁷ Armand Plaka, http://www.giovannarmillotta.it/albania/Shqip_10-06-2006.pdf




Fig. - 14 Stemat e familjeve Feudale në Arbëri

PËRFUNDIME

1. Që nga antike e këndej Heraldika, gjeti hapësirë dhe mbeti në qendër të zhvillimeve të ndryshme shoqëro-politike dhe kulturore.
2. Nga antikiteti ne njohim edhe stemat të Ilirikut, Epirit, Maqedonisë, Dardanisë etj., (Sipas stematores së Paulo Ritter - Vitezoviçit, botuar në Zagreb më 1702.⁴⁹)
3. Në punimin tonë u prekën çështjet, si: Vështrim i përgjithshëm mbi heraldikën si shkencë, përhapjen e saj në qytetet dhe principatat arbërore, duke mos përjashtuar edhe ato familjare, individuale si dhe të esnafëve.

⁴⁹ Sh. Nimani, Trojet shqiptare. op. cit. pp. 115, 117, 118, 119.

4. Me këtë rast mund të themi se në trojet arbërore, krahas luftërave dhe pushtime, u zhvillua edhe kultura.
5. Në këtë fushë u dalluan qytetet, familjet princërore dhe personalitetet kombëtare që u bënë vatra të kulturës.
6. Kështu, përmes Stemave e vulave mund të themi se u soll fryma perëndimore në trojet arbërore dhe më gjerë.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Antoljak Stjepan, [1972]. Shkencat ndihmëse të historisë, Prishtinë – Shkup;
2. Buda, Aleks, [2002]. Shkrime historike 3, Tiranë;
3. Brahaj, Jaho, Emblema shqiptare, Lezhë, mungon data e botimit;
4. Brahaj, Jaho, <http://www.radiandradi.com/heraldika-shqiptare-nga-jaho-brahaj/>
5. Ceka, Hasan, [1965]. Probleme të Numismatikës Ilire, Me një katalog monetare të Ilirisë së Jugut, Tiranë;
6. Drançolli, Jahja, [2008]. Arbitri ndërmjet perëndimit dhe lindjes gjatë mesjetës, Zagreb;
7. Drançolli, Jahja, [2001]. Shteti mesjetar i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut, Pejë;
8. Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe, [1980]. Tiranë;
9. Historia e popullit shqiptarë, [2002]. Tiranë;
10. Hoxha, Gëzim, Gurakuqi, Romeo, [2000]. Hyrje në studimin e Historisë, Shkodër;
11. Nimani, Shyqri, [1996]. Trojet shqiptare në harta dhe stema në shekuj, Nga Straboni e Ptolemeu deri më sot, Prishtinë;
12. Osmani, Jusuf, Arkivistika, [2005]. Teoria dhe praktika, Prishtinë;
13. Plaka, Armand, http://www.giovanniarmillotta.it/albania/Shqip_10-06-2006.pdf
14. Statuti di Skutari, della prima meta del sekole XIV con le addizioni fino al. 1469, a cura di Lucia, Nadin, [2002]. Përkthyer në gjuhën shqipe nga Pëllumb Xhufi, Roma;
15. Stipçeviç, Aleksander, [2002]. Ilirët, Historia, jeta, kultura, simbolet e kultit, Tiranë;
16. Stefa, Monika, Gazeta shqip, Tiranë, 15. 07. 2007;
17. Shkodra, Zia, [1973]. Esnafet Shqiptare (shek. XV – XX), Tiranë;
18. Schmitt, Oliver Jens, [2007]. Arbëria Venedike 1392-1479, Tiranë;
19. Varfi, Gjini, [2000]. Heraldika Shqiptare, Tiranë;
20. Xhufi, Pëllumb, [2006]. Dilemat e Arbitrit, Studime mbi Shqipërinë mesjetare, Tiranë;
21. https://www.google.com/search?q=monedha+nga+shkodra+mesjetare&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKEwiJzYOenaL2AhWIR_EDHbcnBfoQ_AUoAXoECAEQAw&biw=1366&bih=625&dpr=1#imgrc=bwiUxdfn8gTfLM
22. Aleksandër Stipçeviç, Ilirët Historia, Jeta, Kultura, Simbolet e kultit, Tiranë, 2002, p. 265.
23. Ibid. p. 265.
24. J. Braho, material nga internet.
25. Gji. Varfi, Heraldika. op. cit. p. 15.
26. Ibid. p. 15.
27. J. Braho, op. cit.
28. Statuti di Skutari, della prima meta del sekole XIV con le addizioni fino al. 1469, a cura di Lucia Nadin, përkthyer në gjuhën shqipe nga Pëllumb Xhufi, Roma, 2002 p. 226.
29. Oliver Jens Schmitt, Arbëria Venedike 1392 – 1479, Përkthyer nga Adrian Klosi, Tiranë, 2007, p. 146 – 147.
30. Ibid. p. 147.

31. Ibid. p. 147.
32. Zia Shkodra, Esnafet shqiptare (shek. XV – XX), Tiranë, 1973, p. 175.
33. Jahja Drançolli, Arbrit ndërmjet Perëndimit dhe Lindjes gjatë mesjetës, Zagreb, 2008, p. 40.
34. Ibid. p. 49.
35. Ibid. p. 49.
36. Pëllumb Xhufi, Dilemat e Arbrit, Studime mbi Shqipërinë Mesjetare, Tiranë, 2006, p. 79.
37. Ibid. p. 79.
38. Ibid. pp. 84 – 84.
39. Ibid. p. 86.
40. Monika Stefa, Gazeta shqip, 15. 07. 2007, Material i shkëputur nga interneti.
41. Historia e popullit shqiptar I, grup autorësh, Tiranë, 2002, p. 307.
42. Ibid. 308.
43. Gj. Varfi, op. cit. p.48.